

UDHËZIM
Nr.18, datë 19.5.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Pika 2.12 ndryshohet si më poshtë:

2.12 Importuesit e maltos që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizim për importimin e maltos për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë përsëritjeje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore si person i tatueshëm i TVSH-së.

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike

c) Të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesin si importues të maltos.

Importuesi i autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar, e cila do t'i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos te tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos i gjenden sasi të maltos të padokumentuara ose vërtetohen shitje te persona të paautorizuar si prodhues birre, për këto sasi ai detyrohet të paguajë 120 lekë për malto tatim dhe i hiqet e drejta e ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si importues birre. Organi tatimor ka të drejtë t'i mbajë këto shuma nga garancia e derdhur. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e shumave të mësipërme, tatimpaguesi paguan shumën totale ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve, në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Pika 36.3 e udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

36.3 Pa cenuar dispozitat e paragrafit 36.1 më lart, pijet alkoolike të ambalazuara në njësi ambalazhimi me përmasa prej 5 cl ose më pak, si dhe vera e ambalazhuar në fuçi metalike, të konsideruara pajisje nën presion, të cilat shoqërohen me aksesore, me kapacitet mbajtës mbi 5 litra deri në 25 litra, nuk pajisen me pullë akcize. Për verën e ambalazhuar në fuçi metalike të litrazhit të mësipërm, zhdoganimi i rradhës, do të kryhet vetëm pasur të jenë kthyer në shoqërinë furnizuese fuçitë metalike/pajisjet nën presion, të përdorura më parë. Akciza duhet të llogaritet mbi njësi të ambalazuara sipas dispozitave të pjesës XI të këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode